Sot me 27/01/2025

# Akt Themelimi

# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
# " SUNBANK " Sh.p.k.

## Neni 1
## Themelimi

1. Emri i shoqerise eshte " **SUNBANK** " Sh.p.k.", (ketu me poshte e quajtur "**Shoqeria")**. Shoqeria eshte themeluar ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

2. Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

3. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

## Neni 2
## Selia

1. Selia e Shoqërisë do te jete në adresën**: Tirane, Rruga e Kavajes, Garden Building-, Kulla 24, K.6, Ap. 2A**
2. Shoqeria mund te themeloje dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi brenda teritorrit te Republikes se Shqiperise dhe/ose ne shtete te tjere, ne perputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

## Neni 3
## Objekti

1. Objekti i Shoqerise eshte si me poshte vijon:

a.Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

b. Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë:

a) Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te
energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, si dhe i veprave te tyre ndihmese.
b) Aplikimi dhe marrja nga qeveria shqiptare apo institucionet përgjegjëse të shtetit shqiptar i te gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi në Republiken e Shqiperise.
c) Tregtim, instalim dhe mirembajtje impiante fotovoltaike dhe cdo produkti tjeter ne lidhje me kete sektor, import-eksport, dhe shitja me shumice e pakice e tyre,.etj. Ofrimin e shërbimeve të konsulencës inxhinierike elektrike me specifikë teknologjinë fotovoltaike
e)Import dhe eksport i mallrave qe u sherbejne aktivitetit te mesiperm.

c.Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, me individë, shoqëri tregëtare, ente publike apo private, në lidhje me aktivitetin e saj bazë, siç citohet në pikën 3.2 të Statutit. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

2. Objekti i Shoqerise do te jete i kufizuar vetem per sa me siper parashikohen dhe nuk do te perfshije ushtrimin e asnje aktiviteti tjeter perveç se sa me siper u permenden.

## Neni 4
## Kohezgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

## Neni 5
## Kapitali Themeltar dhe Ortaket

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 605.000 leke (gjashteqind e pese mijlek)
5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4 (kater) kuota, me vlere te pergjithshme 605.000 leke (gjashteqind e pese mije e lek)

të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera.

5.3 Ortaket themelues te shoqerise jane:

- Z. Jani Kapurani, i datëlindjes 03.05.1985, lindur në Boboshtice dhe banues në Korce , mbajtës i leter njoftimit nr 038148928, dhe nr personal I50503089R
- Z. Ilias Oumpailis, i datëlindjes 30.06.1982, lindur në Kavalla dhe banues në Selanik-Greqi , mbajtës i kartes se identitetit nr AK 298404
- Z. Georgios Tselepidis, i datëlindjes 10.08.1984, lindur në Selanik dhe banues në Selanik-Greqi , mbajtës i kartes se identitetit nr X 449902
- Z. Konstandinos Stardelis, i datëlindjes 16.07.1966, lindur në Janica -Pellas dhe banues në Selanik-Greqi , mbajtës i kartes se identitetit nr AZ 165468

**5.1 Neni 6**

**Transferimi i Pjeseve**

1. Ortaket nuk kane te drejte te shesin, transferoje, kalojne apo disponojne pjeset e kapitalit ne favor te ndonje pale te trete, pa miratimin paraprak me shkrim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 7**

**Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise, vendimet e se ciles merren ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e Statutit.

**Neni 8**

**Administratori(et)**

8.1 Shoqeria administrohet nga 1 (nje) administrator i emeruar nga Asambleja e Pergjithshme Ortakeve

8.2Administratori i parë i shoqerise do te jete:

- Z. Jani Kapurani, i datëlindjes 03.05.1985, lindur në Boboshtice dhe banues në Korce , mbajtës i leter njoftimit nr 038148928, dhe nr personal I50503089R

8.3 Administratori do të qëndrojë në detyrë per nje periudhe 5 (pese) vjecare, me te drejte riemerimi.

8.4 Shoqeria perfaqesohet ndaj te treteve me nenshkrimin e Administratoreve .

**Neni 9**

**<u>Viti Financiar</u>**

9.1 Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik. Ne perfundim te vitit kalendarik Administratoret hartojne pasqyrat financiare te Shoqerise ne perputhje me ligjet ne fuqi.

9.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor te 2025.

**Neni 10**

**<u>Te ndryshme</u>**

1. Ky Akt Themelimi eshte nenshkruar ne 5 (pes) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe secila me te njejten vlere.

Sot me 27/01/2025

ORTAKET THEMELUES

Konstantinos Stardelis

Georgios Tselepidis